




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIC OF KOSOVO**



**KOMUNA E LIPJANIT**  
**OPŠTINA LIPLJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

Në mbështetje të neneve 12, 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 6, 7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 11,12 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe neneve 9 shkronja c), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 03. 03. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

### **VENDIM**

#### **PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE RIBAR I VOGËL**

##### **Neni 1**

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh personave fizik dhe juridik paluajtshmëria që gjendet në zonën kadastrale Ribar i Vogël në ngastrën kadastrale P-71409052-00314-0 në vendin e quajtur “Selo” me kulturë kullosë e kl.2-të me sipërfaqe prej 29021m<sup>2</sup> e evidentuar në Certifikatën nr.172/2016 ZK Ribar i Vogël në pronësi të Kuvendit Komunal Lipjan.

##### **Neni 2**

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës është ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

##### **Neni 3**

Sipas nenit 1 të këtij vendimi prona ipet në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

##### **Neni 4**

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal 15 Nr.404-13205 të dt.31.03.2014, dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

##### **Neni 5**

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës afatgjatë ta regjistrojë në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim në periudhë afatgjatë.

#### Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspektion.

#### Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

**15Nr. 464-11838**

**Lipjan, më 04. 03. 2016**

#### KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJAN

**KRYESUESJA E KUVENDIT**  
**Vlora Limani-Hajnuni**

